

V E N D I M
Nr.410, datë 19.6.2003

**PËR MIRATIMIN E VLERËS MINIMALE TË AKSIONEVE DHE MIRATIMIN NË PARIM
TË TERMAVE TË MARRËVESHJES ME IFC DHE BERZH, PËR PRIVATIZIMIN E INSIG-
SHA, (FAZA E PARË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.8899, datë 22.5.2002 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG-sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e vlerës minimale të shitjes së aksioneve të INSIG-sh.a. me të cilën Ministria e Financave do të fillojë negociatat me institucionet ndërkombëtare, sipas raportit të vlerësimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin në parim të termave të Marrëveshjes (Term Sheet), të paraqitura nga IFC-ja dhe BERZH-i, në bazë të të cilave do të negociohet marrëveshja për transferimin e së drejtës së pronësisë të aksioneve të INSIG-sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano